



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:182927

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05442468

**C.nr.1648/2021**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtare Diora Bajrami, me bashkëpunëtoren profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. me numër personal ..... nga fshati .... komuna e Dragashit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T.-A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 2,355.31 euro, jashtë seancës, më datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.M. nga fshati ..... komuna e Dragashit, kundër të paditurës M.A.Sh.T.- A.A.P.A.Rr.
- II. DETYROHET e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 18.08.2018 deri më datë 30.06.2021 apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 69.27 euro, në shkallë prej 35 % të pagës bazë – 374.84 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit) t’ia paguaj shumën prej 2,355.18 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 18.08.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A.M. nga fshati .... komuna e Dragashit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 2,355.31 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës pranë Shkollës “Qendra Kompetencës” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Meqenëse paditësi është i licencuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit në nivelin master i shkencave të gjeografisë, në bazë të nenit 7 të kontratës kolektive të datës 18.04.2017, të njëjtit i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 35% të pagës bazë, qka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht. Paditësi realizon pagën bazë prej 344.25 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 35% e kësaj page apo shuma prej 120.48 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 61.92 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 58.56 euro, që nga muaji prill i vitit 2017. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të detyrohet e paditura që në emër të diferencës së pagesës shtesë për kualifikim dhe atë për 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 7 muaj të vitit 2021, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me parashtresën e datës 22.11.2022, paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka bërë precizimin e padisë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që paditësit ti bëhet kompensimi në vlerë prej 35% të pagës bazë 374.84 euro, për periudhën nga 18.08.2018 e deri në 30.06.2021, ti paguhet shuma prej 69.27 euro në muaj, respektivisht për 34 muaj shumën prej 2,355.31 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Kërkesëpadia e paditësit është mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe në bazë të nenit 90 të Ligjit të Punës, kohëzgjatja e kësaj kontrate është 3 vite, që nënkupton se tani nuk është më në fuqi. Sipas nenit 46 pika 2 e Kontratës Kolektive të Arsimit e paditura MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin edhe ndarjen e mjeteve brenda mundësive financiare. Gjithashtu e paditura ka shtuar se bazuar në nenin 341 të LMD-së ku është paraparë “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. E paditura ka vlerësuar se organet kompetente ende nuk kanë arritur që të ndajnë mjetet buxhetore, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar me nenin 35 par.5, 7 dhe 9, “brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare”, andaj deri më tani nuk janë krijuar këto mundësi financiare. Andaj, e paditura me të gjitha të cekurat si më lartë ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi e pa bazuar apo të hudhet si e pa lejuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi A.M. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë “Qendrës së Kompetencës” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkuar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër protokollit 122/3 e datës 06.11.2019, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës që nga data 01.09.2016, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar në nivelin master, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e historisë dhe filologjisë, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me

numër 711, e datës 23.09.2014, e lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Historisë dhe Filologjisë, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin master i shkencave në gjeografi. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Mr.Dr, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 61.92 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). *Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%*”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratës së punës me numër protokolli 122/3 e datës 06.11.2019, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 61.92 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 4 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 35% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësi përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 160.65 euro. Mirëpo në rastin konkret paditësi ka kërkuar kompensimin në emër të licencimit apo kualifikimit në pagën bazë në lartësi prej 374.84 euro në muaj, atëherë gjykata duke u mbështetur në nenin 2.1 të LPK-së, vendos vetëm në bazë të kërkesës së palëve ndërgjyqëse dhe atë paditësit ngritjen në pagën bazë prej 35%, në emër të licencimit apo kualifikimit ia ka llogaritur në pagën bazë të kërkuar në shumë prej 374.84 euro në muaj, e cila është në shumën prej 131.19 euro (374.84x 35%), rrjedhimisht pasi e paditura për çdo muaj në emër në emër të licencimit apo kualifikimit ia ka paguar paditësit shumën prej 61.92, diferenca e mbetur e papaguar për muaj është në shumën prej 69.27 euro e llogaritur (131.19-61.92=69.27).

Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 69.27 euro për periudhën 18.08.2018 deri më datë 30.06.2021 apo diferencën e mbetur për 34 muaj, shumën e përgjithshme prej 2,355.18 euro.

Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 69.27 euro në muaj, duke e shumëzuar për 34 muaj ( $34 \times 69.27 = 2,355.18$  euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 18.08.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket pretendimit e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse, gjykata e vlerësoi të pabazuar. Ngase sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 18.08.2021, ndërsa kërkesa e tij sipas precizimit të kërkesëpadisë ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit për periudhën 18.08.2018 e deri me dt. 30.06.2021 apo për 34 muaj. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit nuk iu është parashkruar kërkesa.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, sepse nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenet 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil  
C.nr.1648/2021, më datë 12.03.2024

Numri i lëndës: 2021:182927  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05442468

Gjyqtare

---

Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.